

STATUTI

Glowled

SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

Në këtë statut

- "Ligji" është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare";
- "Statuti" është Statuti i shoqërisë;

Kreu I

THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA

Neni 1:

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

- (1) Sot, më 05.12.2022 (05 Dhjetor 2022), në themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin **Glowled**.
- (2) Themeluesit e shoqërisë janë:

- Znj. Mariza Vito, shtetas shqiptar, i datëlindjes 26.04.1997, lindur në Librazhd, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i dokumentit të identitetit tip karte me Nr. Personal J75426012H, i lëshuar nga MB në datën 22.12.2014.

Neni 2:

Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetet e mëposhtme:

Import eksport të materialeve elektrike, tregti me shumicë dhe pakicë.

Neni 3:

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë:

Kohëzgjatja e Shoqërisë Glowled vendoset për një periudhë të pacaktuar kohore nga data e regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR).

Mariza Vito 

Neni 4:

Selia

(1) Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: Tiranë, Rruga Shefqet Kuka, Kati 1, Ndertesa Nr 3, Hyrja

Nr 1,

(2) Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon (nëse ka):

mailto:glowled.al@gmail.com

Kreu II

**KAPITALI, KONTRIBUTET E KAPITAL THEMELTAR,
SHPËRNDARJA E KUOTAVE ETJ.**

Neni 5

Kapitali themeltar

(1) Kapitali themeltar fillestas i shoqërisë është 100.000 (Njëqind mijë) Lekë. Pjesëmarja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme. Kontributi i kapitalit themeltar ka ndodhur si vijon:

I.Ortaku Themelues: Znj. Mariza Vito : Zotëruesh i l (një) kuote me vlerë të përgjithshme 100,000 Lekë (Njëqind mijë) që përben 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Ortaku ka depozituar kapitalin themeltar prej 100,000 (Njëqind mijë) lekë në një llogari bankare.

Neni 6:

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërise mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga asambleja e ortakëve e një eksperti kontabël të regjistruar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit. Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kerkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Mariza Vito 

Faqja 2 nga 12

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat mund t'iu transferohen palēve tē treta tērēsish ose pjesērisht nēpērmjet:

- a) kontributit nē kapitalin themeltar;
- b) Blerjes - shitjes sē kuotave;
- c) Trashgimisē;
- d) Dhurimit;
- d) Çfarëdo mjeti tjeter tē parashikuar nga ligji.

Nē rastin e transferimit tē ndonjē titulli te kuotave ndaj palēve tē treta, ortakēt e tjerē mund tē preferohen nē blerjen e kuotave nē proporcion me kuotat e tyre nē tē njëtin çmim dhe nēn kushte tē njëta tē ofruara nga pala e tretē.

Nē këtë rast ortaku shitës duhet t'iu komunikojte ortakëve tē tjerë çmimin e ofruar nga pala e tretë, duke siguruar prova me shkrim tē ofertës, dhe ortakēt e tjerë do tē kenë 30 (tridhjetë) ditë nga marrja e letrës pér tē informuar ortakun shitës dhe ortakēt e tjerë per vullnetin e tyre pér tē ushtruar apo jo tē drejtën e parablerjes. Kur ortakēt e tjerë nuk përgjigjen brenda afatit kohor, do tē thotë se kanë hequr dore nga e drejta e parablerjes nē favor tē tyre.

Nëse një prej ortakëve tē tjerë, që ofrohet pér tē blerë ne parablerje pér pjesen e tij kuotat e ortakut tē shitjes, nuk synon tē ushtrojë tē drejtën e parablerjes, ortakēt e tjerë tē cilët kanë ushtruar tashmë per pjesën e tyre tē drejtën e tyre tē parablerjes mund tē zgjerojne këtë tē drejtë pér tē gjitha ose një pjesë tē kuotave tē ofruara nē parablerje pér ortakun i cili nuk synon tē ushtrojë tē drejtën e tij tē parablerjes.

Nē rast se më shumë ortakë dëshirojnë tē zgjerojnë tē drejtën e parablerjes, tē ofruara pér ortakun i cili nuk synon tē ushtrojë tē drejtën e tij tē parablerjes nē mosmarrëveshje do tē ndahet nē pjesë tē barabarta.

Nē rastin kur vetëm njëri ortak dëshiron tē zgjerojë tē drejtën e tij te parablerjes, parablerjes nē mosmarrëveshje ofruar pér ortakun i cili nuk synon tē ushtrojë tē drejtën e tij tē parablerjes, do tē transferohet plotësisht nē tē gjitha ose pjesën qe ai synon pér tē blerë.

Nē këtë aspekt, anëtarët dëshirojnë tē zgjerojnë tē drejtën e tyre tē parablerjes duhet tē njoftojë ortakun shites, vendimin e tij brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga marrja e njoftimit tē mungesës pér tē ushtruar tē drejtën e parablerjes.

Të gjitha këto komunikime duhet tē jenë me shkrim.

Marina Vito 

Faqja 3 nga 12

KREU III
ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organii Vendimmarres

Asambleja e Pergjithshme e Ortakëve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Pergjithshme e Ortakëve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteteve te percaktuara ne ligj.


Asambleja e Pergjithshme e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të regjistruar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh)mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshire përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) shperndarjen e fitimeve vjetore
- f) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- g) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- h) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- i) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- j) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- k) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Mariia Vito 

Faqja 4 nga 12

Vendimet e shumicës të Asamblese janë detyruese per ortakë qe mungojnë ose jane kundër, por kane te drejten e ankimit në rastet, afatet dhe format e parashikuara nga ligji.

Neni 9

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja duhet te thirret nepermjet njoftimit me leter rekomande që duhet t'u dërgohet ortakëve – në adresen qe rezulton ne Librin e Ortakëve ose nepermjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 (shtate) ditë përpëra datës së caktuar për mbledhjen e asamblesë

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij nenit, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10

Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.


Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ”, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

Vlazur Vito



Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave te zoteruesve te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpérblimeve
- e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- f) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- g) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- k) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 12

Përjashtimi nga e drejta e votës

1.Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:


- a)vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b)shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c)ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç)dhënen ose jo të përsitimeve të reja.

2.Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13

Administrimi

Marija Vito



Faqja 6 nga 12

(1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, eshte 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

(2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

(3) Personat e mëposhtëm caktohen si Administratorë të parë të shoqërisë deri në emërimin e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme.

Të dhënat e identifikimit:

dhe specimenët e nënshkrimit:

(mbiemrat, emrat, adresat):

- Mariza Vito

TIRANE

Neni 14

Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen përmajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave-kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet përmirësuarje, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme përmiratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur përrrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin përmirësuar të Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë përmirësuarje, që përfshijnë financiarët, rezulton ose ekziston rreziku që aktiviteti i shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratorët janë te detyruar te therasin Asamblene e Përgjithshme, në rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktiviteti i shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

Faqja 7 nga 12

-shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjeter aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 përqind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara. -shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të bljë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 përqind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15

Pergjegjesite e Administratorit

Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrit të shoqërisë.

Pasojet e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojet përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërsi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

c) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

Maria Vito



3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standarde profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, eshte i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshte i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare“, kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- d) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimitarit tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit. Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpérblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Kreu IV

VITI FINANCIAR-EKSPERTËT KONTABËL

Neni 16

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbylltet me 31 Dhjetor.

Neni 17

Ekspertët Kontabël

Maurizio Vito



Faqja 9 nga 12

Nëse është e nevojshme apo tē kérkohet nga ligji, kontrolli i pasqyrave financiare dhe librave të shoqerisë do t'i besohet një audituesi të autorizuar të emëruar në mënyrën e përcaktuar me ligj me te drejtë riemërimi.

Eksperti ka per detyre qe tē kontrolloje të gjithe dokumentacionin kontabel të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer një gje tē tille i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i regjistruar percatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit finanziar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakëve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e tē drejtë vendimore qe ka.

Eksperti kontabel i autorizuar mund te shkarkohet sipas menyes se njejtë te emerimit.

Neni 18

Fitimet

Fitimet neto qe rezultojne nga bilanci vjetor, zbritur 5% (pese perqind) që caktohen per rezerven ligjore deri ne 10% (dhjete per qind) te kapitalit themeltar, dhe gjithashtu te gjitha shumat e tjera qe Asambleja vendos t'i vere menjane, u shperndahen ortakëve ne proporcione pjeset e kapitalit themeltar te zotera respektivisht.

Asambleja mund te vendose edhe zbritje te vecanta ne favor te rezervave te jashtezakonshme ose per qellime te tjera apo edhe shtyrjen e shperndarjes se fitimeve, plotesisht ose pjeserisht, per vitet financiare te ardhshme.

Kreu V

PRISHJA – RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

Neni 19


Prishja dhe Likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërise mund tē bëhet në çdo kohë :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakëve;
- c) me hapjen e procedurave tē falimentimit;

Faaja 10 nga 12

Maria Vito



ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";

d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortakët merrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtesë " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët.

Nëse Ortakët nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 20

Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

Neni 21

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjeter specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 22

Mosmarrëveshjet

Mario Vite



Faqja 11 nga 12

Per mosmarrëveshjet që mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

U lexua, u nenshkrua dhe u firmos.

O R T A K Ē T

E SHOQĒRISE ME PĒRGJEGJĒSI TĒ KUFIZUAR

Glowled

Mariza Vito

Mariza Vito 